



Datë: 08.05.2025
Numër Protokolli: 3225/2025

A.nr.434/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Ylber Fetahaj- në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.434/2025 të datës 07.03.2025, të parashtruar nga ankuesi A.M, kundër organit të punësimit/Agjencia e Regjistrimit Civil- Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “shkelje e të drejtës në pagë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 08.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.434/2025 e datës 07.03.2025, e parashtruar nga ankuesi A.M.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, A.M (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi*), i punësuar në Agjencinë e Regjistrimit Civil-Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 07.03.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me klasifikimin e vendit të tij të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, më datë 20.03.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit më datë 04.04.2025, ka përcjell shkresat e lëndës lidhur me çështjen për vendosje.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe referuar pretendimeve ankimore të parashtruara nga ankuesi, ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt emërimit me Nr.Ref.ARC/QPD-6/2020 të datës 30.10.2020, ushtron pozitën e punës *Asistent Administrativ ne Qendrën për Pajisje me Dokumente ne Malisheve*, pranë Agjencisë së Regjistrimit Civil-Ministria e Punëve të Brendshme.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se që nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, është diskriminuar në raport me punën dhe pagën që realizon, ngase organi përkatës i punësimit ka hapur konkurse dhe ka rekrutuar zyrtarë që për punë dhe kualifikim të njëjtë paguhen me koeficient të pagës 5.6, ndërsa i njëjti thekson se është i punësuar nga viti 2019 dhe realizon koeficient të pagës 4.5, duke theksuar se organi i punësimit paraprakisht duhej të bënte nivelizimin e pagave për zyrtarët që janë në marrëdhënie pune pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Pagave dhe Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Agjencia e Regjistrimit Civil ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procedimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik dhe Rregullores përkatëse për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë.

Andaj, duke qenë se organi përkatës i punësimit në këtë rast Agjencia e Regjistrimit Civil, nuk ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës sikurse përcaktohet me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, në fuqi nga data

28.02.2024, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e parakohshme, dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritore. Rrjedhimisht, e njëjta është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitive të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës së theksuar më lart, ankuesit do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.434/2025

Ylber Fetahaj

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A.M;
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.